



 **VOLUNTARY
RETURN HOME**

© IOM 2018

**PO MENDONI TË KTHEHENI NË VENDIN
TUAJ? NE MUND T’JU NDIHMOJMË TË
KTHEHENI VULLNETARISHT.FEDASIL
ORGANIZON DHE FINANCON UDHËTIMIN
TUAJ TË KTHIMIT. DHE SË BASHKU NE
SHQYRTOJMË SE SI MUND T’JU MBËSHTESIM
NË VENDIN TUAJ TË ORIGINËS.**

**0800 32 745 (free number)
www.voluntaryreturn.be**

ÇFARË ËSHTË KTHIMI VULLNETAR?

1

Kthimi vullnetar është rikthim në vendin tuaj të origjinës. Ky rikthim bëhet i mundur mbasi që ju keni vendosur të ktheheni. Udhëtimi është i njëjtë me atë të pasagjerëve të zakonshëm. Autoritetet në vend nuk lajmërohen para për rikthimin tuaj. Jeni në çdo kohë të lirë të vendosni të mos ktheheni.

SI BËHET KËRKESA PËR KTHIMIN VULLNETAR?

Mund të kontaktoni me një nga qendrat për kthim në Belgjikë, mund të informoheni tek asistenti social, ose mund të kontaktoni këtë numër falas të telefonit 0800 327 45.

2

KUSH MERRRET ME ORGANIZIMIN E KTHIMIT?

Fedasil (Agjencia Federale për strehimin e azilkërkuesve) është institucioni përkatës i cili merret me programin e kthimit vullnetar. Organizata Ndërkombëtare për Emigracion (IOM) organizon kthimin në atdhe me avion ose me autobus për vendet e ballkanit. IOM së bashku me organizatën ndërkombëtare Caritas merren me dhënien e ndihmës dhe mbështetjes së mundshme pas rikthimit.

3

A DUHET TË PAGUANI?



Jo, nuk paguani asgjë. Fedasil-i paguan për biletën tuaj të avionit ose autobuzit, si edhe për transportin tuaj deri në aeroport ose deri në stacionin e autobuzit. Duhet të pajiseni me një dokument udhëtimi pranë konsullatës së vendit tuaj dhe për këtë do të rimbursoheni kur të niseni.

4

SA BAGAZHE JU LEJOHET TË MERRNI?

5

Për këtë duhet të respektoni rregullat e kompanisë me të cilën do të udhëtoni dhe nuk duhet të kaloni numrin e lejuar të bagazheve për person. Mos e harroni këtë gjë!



A JENI TË SHOQËRUAR GJATË UDHËTIMIT?

6

Po, para sa të niseni nga Belgjika një punonjës i IOM-it ju përshëndet, ju jep biletën e udhëimit dhe ndonjë ndihmë financiare, si edhe ju shoqëron deri në pikën kufitare. Nëse dëshironi një tjetër person do t'ju presë në vendin tuaj. Për këtë ju kërkohet të mbani në dorë një qese të IOM-it në mënyrë që persni të mund t'ju njohi.

JETA NË VENDIN TUAJ ËSHTË E VËSHTIRË; ÇFARË MBËSHTETJE MUND TË MERRNI?

Ne bashkëpunojmë me partnerët lokalë në vend dhe ata mund t'ju ndihmojnë të riintegrohni. Me këtë nënkuptojmë mbështetje për të filluar një aktivitet privat, mbështetje për mbulimin e shpenzimeve mjekësore ose mbështetje për punësim. Kjo lloj mbështetje nuk ju ofrohet të gjithëve, çdo rast është ndryshe. Ju lutemi të informoheni nëpërmjet personin tuaj të kontaktit për më shumë informacion mbi ndihmën e ofruar në vend. Edhe ndihma financiare e mundshme jepet normalisht para kthimit.

7

This brochure is intended for foreigners without a residence permit in Belgium. It is available in 19 languages: Albanian, Amharic, Arabic, Bulgarian, Chinese, Dutch, English, Farsi, French, Lingala, Mongolian, Pashto, Portuguese, Fula, Russian, Serbian, Slovak, Spanish and Tigrinya. You can download the different language versions on www.retourvolontaire.be/fr/ partners.



CONTACT US.

www.voluntaryreturn.be/contact-us

